REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.Prot 4332                                                  Kuçovë, më 31/12/ 2021

VENDIM

Nr. 85, dt. 23 .12.2021

# BUXHETI

# AFATMESËM
# 2022-2024

# BUXHETI 2022

PBA është në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Per menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperise", i ndryshuar, te ligjit nr 9632 date 30/10/2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" te ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave nr. 23 datë, 30.07.2018 "Për procedurat standarde të pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Këshillit Bashkiak pasi shqyrtoi dokumentin e paraqitur, vendosi të miratojë PBA 2022-2024, Buxhetin 2022, për Bashkinë Kuçovë.

PËRMBAJTJA

- HYRJE.....................................................................................3
- PLANI FINANCIAR I BASHKISË ............................................................7

  Të ardhura nga taksat vendore
  Të ardhura nga tarifat vendore
  Të ardhura nga taksat e ndara
  Të ardhura të tjera
- PLANIFIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE.......................
- FUNKSIONI 011: SHËRBIME TË PËRGJITHSHME PUBLIKE
  Programi 01110: Planifikim, menaxhim, administrim..............................15
  Programi 01120: Çështje financiare dhe fiskale......................................17
- FUNKSIONI 03: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE
- Programi 03140: Shërbimet e Policisë Vendore......................................19
- Programi 03280: Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile .......................20
- FUNKSIONI 04: BUJQËSIA, PYJET, PESHKIMI DHE GJUETIA
  Programi 04220: Shërbimet bujqësore......................................................21
  Programi 04240: Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit .........22
  Programi 04260: Administrimi i pyjeve dhe kullotave ..........................23
- NËNFUNKSIONI 045: TRANSPORTI
  Programi 04530: Rrjeti rrugor...............................................................25
- FUNKSIONI 05: MBROJTJA E MJEDISIT
  Programi 05100: Menaxhimi i mbetjeve..................................................27
  Programi 05630: Ndërgjegjësimi mjedisor...............................................28
- FUNKSIONI 06: STREHIMI DHE KOMODITETE E KOMUNITETIT
  Programi 06140: Planifikimi urban vendor..............................................31
  Programi 06140: Strehimi........................................................................32
  Programi 06210: Programet e zhvillimit...................................................33
  Programi 06260: Shërbime publike vendore............................................34
  Programi 06370: Furnizimi me ujë.............................................................
  Programi 06440: Ndriçim rrugësh...........................................................35
- FUNKSIONI 08: ARGËTIMI, KULTURA DHE FEJA
  Programi 08130: Sport dhe argëtim........................................................40
  Programi 08220: Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore......36
- FUNKSIONI 09: ARSIMI
  Programi 09120: Arsimi bazë dhe parashkollor.......................................40
  Programi 09230: Arsimi i mesëm i përgjithshëm......................................42
- FUNKSIONI 10: MBROJTJA SOCIALE
  Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët..........................43
- PLANIFIKIMI I INVESTIMEVE ..............................................................51
- PRIORITETET E INVESTIMEVE ...........................................................53
- TREGUESIT FINANCIARË.....................................................................56
- INSTRUMENTI I PLANIFIKIMIT FINANCIAR........................................
- DETYRIME TË PRAPAMBETURA.........................................................

# HYRJE

## Vështrim i përgjithshëm:

**Misioni i Bashkisë Kuçovë:** *Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim.*

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit, dhe shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll, e në jug e jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej 160.22 km², territori i Kuçovës së sotme e tejkalon atë të rrethit të Kuçovës, duke përfshirë nën juridiksionin e saj edhe njësinë administrative Lumas, krahas njësive Kuçovë (qendër), Perondi e Kozare. Nga pikëpamja administrative, Kuçova kufizohet me bashkitë Lushnje, Belsh, Cërrik, Gramsh, Berat dhe Ura Vajgurore.
Sipas regjistrit të gjendjes civile, numri i popullsisë është si në tabelë:

| Nr. i popullsisë | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|
| Kuçovë | 29,758 | 29,442 | 25,519 | 29,321 |
| Perondi | 10,636 | 10,675 | 10,936 | 10,978 |
| Kozare | 8,100 | 8,122 | 8,357 | 8,417 |
| Lumas | 7,024 | 6,931 | 6,962 | 6,979 |
| Total | **55,518** | **55,170** | **51,774** | **55,695** |

Kuçova ka një ndër dendësitë më të larta në rajonin e Shqipërisë Qëndrore, me 348 banorë/km². Rreth 80% e kësaj popullsie është vendosur në qytetin e Kuçovës, dhe në njësinë administrative Perondi. Bashkia ka nën administrimin e saj 31 fshatra dhe një qytet.
Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Kuçovë është 84 km², sipërfaqja më e madhe e të cilës zihet me bimësi natyrore 36,57 km² dhe nga tokë arë e kultivuar me lloje të ndryshme kulturash bujqësore 26,11 km².

Territori i bashkisë ka mbulim të mirë me **shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve** Kuçovë, SHAUK ofron shërbimin në bashkinë Kuçovë dhe njësitë administrative Perondi, Kozarë, ndërsa në njësia administrative Lumas është e pambuluar me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Kuçovë, furnizohet me ujë nga burimi i Bogovës ashtu si dhe bashkia Berat dhe puset e Fushës së Devollit të cilat furnizojnë me ujë fshatrat Tupi, Drizë, Goraj, Velagosht Gegë dhe Polovinë. Sasia e ujërave që shfrytëzohet nga Burimi i bogovës është mesatarisht 2000l/sek në periudhën e dimrit deri në 350 l/sek në periudhën e verës. Sasia totale (burimi i Bogovës dhe puset e Devollit) mesatare e ujit që shfrytëzohet nga ndërmarrja e ujësjellës – kanalizimeve në bashkisë Kuçovë është 602.5 l/sek.
Bashkia e Kuçovës ka një **rrjet të pasur ujor**. Në veri-perëndim, për rreth 12.5km Bashkia përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Devoll i cili bashkohet me Lumin Osum në Arrëz të Urës Vajgurore.
Në Kuçovë ndodhen edhe një numër rezervuarësh ndër të cilët mund të përmendim ujëmbledhësin e Gorajt në pjesën qendrore të bashkisë, ujëmbledhësin e Belesovës në pjesën perëndimore, Ujëmbledhësin ndërmjet fshatrave Gegë dhe Drizë dhe ujëmbledhësin në Salcë-Kozarë. Një sërë përrenjsh të vegjël përshkruajnë pothuajse të gjithë territorin e bashkisë të cilët shërbejnë si burime ushqyese të lumenjve të mëdhenj Osum, e Devoll. Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

**Fondi Pyjor e kullosor** i Bashkisë së Kuçovës është rreth 4,600 ha dhe gjendet kryesisht në tre komunat e bashkisë që janë Kozare, Perondi dhe Lumas. Komuna Lumas dallohet për sipërfaqen më të madhe të këtij fondi me 3241 ha e ndjekur nga Komuna Perondi me 383 ha dhe Kozarë me 976 ha.
**Mjedisi:** bashkia ndeshet edhe me **sfidat e ndotjes së ajrit dhe të tokës** nga industria e naftës dhe burime të tjera të cilat ndikojnë dhe në prodhimin e produkteve bujqësoree blegtorale. Dy nga ndotësit më të përhapur në qytetin e Kuçovës dhe në zonën përreth janë LNP-ja, e cila e ka origjinën nga automjetet që lëvizin në zonë, dhe H2S e cila e ka origjinën nga industria nxjerrëse e naftës që operon në zonë. Ndërkohë, falë industrisë nxjerrëse të naftës, lëndë të tjera ndotëse në ajër të cilat nuk janë mbi normat e lejuara janë edhe oksidet e squfurit, si trajta SO2 dhe benzeni të cilat në të shumtën e rasteve janë mbi normat e lejuara, duke u bërë burim i shumë sëmundje të mushkrive dhe ndotjes së mjedisit. Në këto kushte, Bashkia Kuçovë ka prioritet shtimin e

hapsirave të gjelbra pranë industrive ndotëse, si dhe të bashkëpunojë me inspektoriatet shtetërore dhe vendore të mjedisit për kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore të bizneseve përpunuese të naftës.

**Situata e punësimit** në nivel njësie administrative është e diversifikuar për Kuçovën dhe mjaft e orientuar drejt sektorit bujqësor për Kozaren, Perondinë dhe Lumasin. Në Kuçovë, sektori kryesor, me 40% të të punësuarve, janë shërbimet, ndjekur ngushtësisht nga industria (33.5%) dhe më pas tregtia. Sektori i ndërtimit dhe i bujqësisë zë një peshë shumë të ulët (rreth 2% të të punësuarve). Nga njësitë e tjera administrative, Perondia ka një diversifikim disi më të madh, me sektorin e shërbimeve që zë 10% të punësimit. Edhe në Lumas, ky sektor zë një peshë të madhe, 9.6%, në raport me sektorët e tregtisë, industrisë, etj. Gjithsesi në këto njësi, sektori bujqësor është dominues në vlera 71-82%. Kuçova ka një normë 20.5% të papunësisë, përkundrejt normës mesatare kombëtare.

**Gjendja e përgjithshme e strehimit** në Bashki është problematike. Aktualisht, situata e aplikantëve për strehim social është si më poshtë:

Totali i familjeve që kanë aplikuar për një ndër programet e strehimit social **është 377 familje.**

| | Aplikantë |
|---|---|
| Familjet Rome | 25 |
| Familjet Egjiptiane | 21 |
| Familje me kryefamiljare femër | 20 |
| Prind i vetëm | 16 |
| Të moshuarit | 13 |
| Personat me aftësi të kufizuara | 21 |
| Çifte të reja | 1 |
| Familje që kanë ndryshuar vendbanim | 3 |
| Përfitues të ndihmës ekonomike | 252 |
| Familje të mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave të ish-pronarëve | 0 |
| Të tjerë… | 5 |

Të strehuar në banesa me qera gjatë viteve 2020-2021, janë 10 familje, 2 nga të cilat i përkasin komunitetit Rom.

**Rrugët**, në Bashkinë Kuçovë rezulton të ketë 314 km rrugë lineare gjithsej, duke përfshirë nga rrugët arteriale, deri te ato peizazhistike e bujqësore. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë **(2012)**, në qytetin e Kuçovës ka patur 3.4 km rrugë lineare. Pra, bashkia e sotme qëndron para sfidës për të rikonstruktuar, mirëmbajtur dhe mbështetur me shërbime një rrjet rrugor 90 herë më të gjatë se i mëparshmi.

Shpërndarja e rrugëve sipas kategorisë së Kodit Rrugor dhe gjatësisë respektive;

Kategoria e rrugës Gjatësi (km).

Rrugë inter-urbane/rurale kryesore 23

Rrugë inter-urbane/rurale dytësore 37

Rrugë urbane/rurale kryesore 4

Rrugë urbane/rurale dytësore 56

Rrugë lokale 194

**Mbetjet Urbane;**

Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Kuçovë ofrohet nga sipërmarrje private, e cila bën grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në venddepozitimin e tyre që ndodhet përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në Rreth Tapi, në një largësi 4km nga qyteti i Kuçovës. Ky venddepozitim funksionon që prej vitit 1987.

Në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerianë nëpërmjet projektit SECO është bërë i mundur rehabilitimi i plotë i këtij venddepozitimi sipas standarteve dhe legjislacionit në fuqi. Që nga muaji Mars i vitit 2021 ky venddepozitim është marrë në dorëzim nga Bashkia Kuçovë dhe tashmë menaxhohet prej saj.

Gjithashtu kemi një plan operacional të menaxhimit të venddepozitimit të hartuar sipas ligjit me ndihmen e ekspertëve të projektit, i cili po zbatohet për mbarëvajtjen e metejshme.

Venddepozitimi shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 18,500 m2 duke përfshirë disa nënstruktura të nevojshme për një venddepozitim të kontrolluar. Ai është projektuar dhe ndërtuar si një strukturë e vetme për një volum të përgjithshëm pritës prej 74,000 m3 dhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme shoqëruese duke marrë në konsideratë dy faza (atë të asgjesimit të mbetjeve ekzistuese të hedhura në mënyrë të pakontrolluar (të përfunduar) dhe atë të asgjesimit të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim deri në momentin e ndërtimit të një venddepozitimi të ri). Kjo qasje ka të bëjë me reduktimin e ndotjes së shkaktuar nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve, minimizimin e ndotjes në vijim dhe parandalimin e saj në periudhë afatgjatë. Për të dy këto zona, ose faza asgjesimi mbetjesh të ngurta urbane në mënyrë të kontrolluar është ndërtuar dhe përdoret e njëjta zonë shërbimi, i

njëjti sistem për menaxhimin e lëngut kullues nga venddepozitimi dhe për drenazhimin e ujërave atmosferike, si dhe e njëjta metodologji e kapjes së gazit. Strukturat kryesore të marra në konsideratë për të dy fazat janë:

• Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve ekzistuese mbas mbylljes (Faza e parë)
• Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim (Faza e dytë)
• Sistemi i drenazhimit dhe trajtimit të lëngut kullues nga venddepozitimi
• Sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferike
• Sistemi i mbledhjes së gazit
• Porta hyrëse dhe rrethimi
• Shërbime shtesë dhe plotësuese (sheshi që do të përdoret për riciklim, kompostim dhe transferim të mbetjeve në të ardhmen, zyrat, rrugët e brendshme dhe perimetrale, furnizimi me energji, ndriçimi dhe furnizimi me ujë).

Jetëgjatësia e këtij venddepozitimi, specifikisht zona e re e asgjesimit të mbetjeve, do të jetë 5 vjet dhe nëse parashikohen ndërhyrje dytësore (diferencimi, kompostimi), atëherë koha e përdorimit të kësaj infrastrukture rritet.
Menaxhimi i venddepozitimit përfshin proçesin e asgjesimit të mbetjeve, menaxhimit të gazit, lëngut kullues dhe ujërave atmosferike si në fazën operacionale, ashtu edhe post mbylljes së tij, ku të gjitha proçeset së bashku varen nga sjellja e mbetjeve dhe metoda e asgjesimit të tyre.
Për këtë, gjatë kryerjes së proçeseve të punës apo aktiviteteve në zonën e asgjesimit të mbetjeve duhet tëmerren në konsideratë si më poshtë:

• Formimi i një trupi të vetëm mbetjesh, gjeometrikisht uniform dhe relievit të qendrueshëm gjatë fazës operacionale.
• Kufizimi dhe reduktimi i depërtimit të ujërave atmosferike në trupin e mbetjeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen artificiale të sasisë së lëngut kullues nga venddepozitimi, në proçesin e formimit të gazit dhe qendrueshmërinë e shtresave të kultivimit dhe mbulesës duke shkaktuar efekte negative në mjedis dhe rrjedhimisht rritje të kostove operative.
• Menaxhimi dhe kontrolli korrekt i sistemit të drenazhimit, grumbullimit dhe trajtimit të lëngut kullues nga venddepozitimi deri në shkarkimin fundor.
• Menaxhimi dhe kontrolli i sistemit të kapjes dhe shkarkimit të gazit
• Menaxhimi efikas i burimeve njerëzore dhe teknologjike të disponueshme në objekt Përsa më sipër, detyra e operatorit të menaxhimit të objektit është:
• Të kontrollojë vendosjen e shtresave të mbetjeve, ngjeshjen, mbulimin dhe respektimin e kuotave dhe pjerrësive sipas projektit teknik/vizatimeve
• Të kontrollojë vazhdimisht venddepozitimin dhe sistemin e shkarkimit të ujërave me qëllim garantimin e mirëmbajtjes së rrjetit të shkarkimit dhe rrjeteve të drenazhimit të ujërave sipërfaqësore.
• Të kontrollojë periodikisht mirëmbajtjen e argjinaturave mbajtëse, rrethimit perimetral, portës hyrëse për në kantier dhe të zëvendësojë çdo element të dëmtuar sa më shpejt, në mënyrë që të eleminohet hyrja e kafshëve dhe personave të paautorizuar.
• Të kontrollojë në mënyrë konstante makineritë dhe pajisjet e nevojshme.
• Të kufizojë përhapjen e pluhurave dhe emetimeve të aromave të pakëndshme në mjedis duke marrë këto masa parandaluese:

- kufizimi i sipërfaqes së mbetjeve të ekspozuar ndaj agjentëve atmosferike 8- 25 m2 - kompaktim i mbetjeve ditore - mbulimi i mbetjeve me material dheu në fund të ditës ose sipas periodicitetit të përcaktuar, por jo në më pak se 3-4 ditë depozitim

• Të kontrollojë dhe shmangë përhapjen e insekteve dhe parazitëve duke marrë këto masa parandaluese:

- të mos mbeten sipërfaqe të mbetjeve pa mbuluar me material dheu si dhe zona në të cilat konstatohen plasaritje në venddepozitim.

Gjithashtu të respektohet kuota e njëjtë në të gjithë sipërfaqen e venddepozitimit me qëllim evitimin e pellgjeve me ujëra të ndenjur që nxisin shumimin e insekteve

- të ndërhyhet me metoda kontrolli të mizave dhe brejtësve, të realizuara nga personeli i kompanive të specializuara nën mbikëqyrjen e operatorit të venddepozitimit
- të ruajë pjerrësinë e faqes ballore të mbetjeve për të nxitur rrjedhjen e ujit të shiut dhe për të shmangur krijimin e pellgjeve të përkohshëm, të cilët mund të destabilizojnë mbetjet dhe të pengojnë funksionimin e duhur të përditshëm të mjeteve që operojnë në venddepozitim
- të minimizojë sipërfaqen e pambuluar të mbetjeve për të reduktuar volumin e ujit në shtresat fundore të venddepozitimit.

**Shërbimi parësor:**

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shërbime dentare dhe 9 farmaci. Kërkohet të shtohet një qendër shëndetësore në njësinë Perondi dhe 2-3 qendra shëndetësore, ose ambulanca konsultore në njësinë Kuçovë, për të përmbushur standardet e kërkuara të sigurimit të shërbimit parësor.

**Arsimi:** një vëzhgim i përgjithshëm i objekteve arsimore sugjeron se përgjithësisht, gjendja e tyre është mesatare, me nevojë për rikonstruksione të pjesshme. Të gjitha kopshtet kanë nevojë për pajisje mësimore dhe laboratorike, dhe në 50% të rasteve rruga për në to është e paasfaltuar. Vetëm 60% e kopshteve janë të pajisura me terren sportive.

Sa i takon shkollave të mesme, pjesa më e madhe e tyre kanë akses të mirë, me rrugë të asfaltuar. Janë identifikuar shkollat që janë në gjendje të përgjithshme të degraduar, në nevojë për rikonstruktim tërësor: Shkolla e Kozares, Zdravës dhe Salcë Kozares, Tapi. Asnjë nga objektet arsimore nuk ka laboratorë dhe të gjithë kanë nevojë për pajisje dhe mjete mësimore. Gjithsesi gjendja e shkollave të mesme është përgjithësisht e mirë, dhe aksesi në to bëhet me rrugë të asfaltuar. Edhe në këto objekte mungojnë tërësisht laboratorët dhe ka nevojë për mjete mësimore, por të gjitha sigurojnë terren sportiv dhe kanë kapacitete optimale klasash, pa konsideruar alternativën e kryerjes së mësimit me dy turne.

**Mbrojtja sociale:**

Qarku Berat, renditet ndër qarqet me përqindjen më të madhe të varfërisë në rajon (12.7%), krahasimisht me qarqet fqinje të Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës, etj.

Si rezultat i kushteve të jetesës në varfëri ekstreme, ose pjesërisht-ekstreme, mesatarisht 347 familje përfitojnë ndihmë ekonomike nga buxheti i shtetit dhe rreth 65 familje nga fondet e Bashkisë.

**Shërbimet sociale;**

Nën administrimin e bashkisë nuk ka qendra sociale për të moshuar, për komunitete të ndjeshme, apo probleme sociale specifike. Këto shërbime mbulohen pjesërisht nga prezenca e një qendre rinore, me bibliotekë të përfshirë, një qëndre kulturore, një qëndre kulturore fëmijësh, qendrës për fëmijët me aftësi ndryshe si dhe ambienteve sportive në stadium, dhe në aneksin e fushës së sportit "1 Maji", në qytetin e Kuçovës.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën: 2022- 2024. **Viti i parë i PBA, është buxheti vjetor për vitin 2022.**

## 2. Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA);

a. Krijimi i një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve, të shprehura në Strategjine e Zhvillimit Ekonomik të Bashkise Kuçovë, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion.

b. Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

c. Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve.

d. Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve.

e. Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

## 3. Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA):

**Objektivi strategjik 1**: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomiko-social, duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

**Objektivi strategjik 2**: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale, për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit, dhe në itinerarет turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të mobilitetit, transportit, dhe shërbimeve të lidhur me infrastrukturën.

**Objektivi strategjik 3**: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor, në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementët e fortë natyrorë dhe artificialë, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike.

**Objektivi strategjik 4**: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor.

Të cilat synohen të arrihen nëpërmjet:

a. Përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritjes së efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore, që është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b. Sigurimit të një shpërndarjeje dhe përdorimi me efektivitet të burimeve.

c. Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore, forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve të fondeve.

d. Përmirësimi i administrimit të taksave dhe financave në zbatim të plotë të legjislacionit dhe përgjegjësisë individuale e kolektive.

e. Rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit në buxhetim dhe llogaridhënie.

**4. Kush përfshihet në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA)**

a. Administrata dhe sektori mbështetës i Bashkisë,
b. Ndërmarrjet e varësisë.
c. Institucionet e varësisë.

Referuar termave të Ligjit të Ri Organik të Buxhetit, su më sipër, do të quhen **Njësi Shpenzuese**.
Si një proces që përfshin Bashkinë dhe të gjitha institucionet në varësi të saj, PBA mbetet një sfidë për përmirësimin e planifikimit dhe përdorimin efektiv të burimeve në dispozicion.
Kështu, çdo program i veçantë do të përfshijë të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij.

Shpenzimet përbëhen nga:

a. Shpenzimet administrative (paga, sigurime dhe shpenzimet operative të Njësive Shpenzuese),
b. Shpenzimet kapitale.

PBA është hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe mbështetet në trajnimet e specialisteve të financës, tatim - taksave, shërbimeve publike, të organizuara nga Ministria e Financave, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, USAID-i, DLDP, Ambasada Zvicerane, si dhe mbeshtetur në pervojen pozitive të njësive të tjera vendore.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara :

- Gjatë punës sonë të përditshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.
- Nga shqetësimet e përcjella nga Komisioni Qytetar.
- Nga kerkesat dhe ankesat e qytetareve adresuar drejtorive përkatëse.
- Dëgjesat publike.

Kërkesat dhe shqetësimet e marra nga banorët lidhen me :
-Zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.
-Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore.
-Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve.
-Mirëmbajtjen e kanaleve kulluese e ujitëse.
-Shtimin e fondeve për mbështetjen e shtresave në nevojë.
-Kërkesa për strehim.

Kërkesat e mësipërme janë mbajtur në konsideratë gjatë përgatitjes së buxhetit, brenda mundësive financiare që lejojnë fondet në dispozicion.

## -PLANI FINANCIAR I BASHKISË 2022 – 2024

Në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, të ligjit nr 9632 date 30/10/2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave nr. 23 datë, 30.07.2018 "Për procedurat standarde të pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", Urdhërit të Kryetarit të Bashkise nr. 125 datë, 30.12.2012 (i ndryshuar me UB nr. 92 dt. 23.04.2019) u ngrit **Grupi per Menaxhimin Strategjik (GMS)** dhe urdhër të brendshëm nr. 93, dt. 01.11.2016 për krijimin e EMP, i ndryshuar me UB nr. 93 dt. 24.04.2019 , VKB nr. 35 datë 31.05.2017 për krijimin e GSBI.
Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është mbështetur në këto dokumenta:

- Planin e përgjithshëm vendor.
- Planin e Investimeve Kapitale (PIK).
- Plani social vendor.
- Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve urbane.

Parashikimi i treguesve ekonomiko-financiarë për periudhën 2022-2024 është mbështetur në kriteret e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit te Financave nr. 8 date 29.03.2012 "Per procedurat standarde të pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", si dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7, datë 26.02.2021 " Për përgatitjen e Projekt Buxhetit Afat Mesëm 2022-2024.

Totali i të ardhurave të veta së bashku me transfertën e kushtëzuar e të pakushtëzuar do të mbulojnë shpenzimet për funksionet e veta, të përbashkëta e të deleguara, të cilat i ushtron Njësia e Qeverisjes Vendore.
Me shkresë të Ministrisë së Financave me nr. 4008/1 prot., dt. 26.02.2021 është dërguar transferta e pakushtëzuar për përgatitjen e PBA:

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar të parashikuar në tre vitet e PBA-së :
  - Për vitin 2022 është parashikuar 165,194,000 lekë.
  - Për vitin 2023 është parashikuar 174,209,000 lekë.
  - Për vitin 2024 është parashikuar 185,679,000 lekë.

Me shkresë të Ministrisë së Financave me nr. 18976 prot., dt. 29.10.2021 është konfirmuar:

- transferta e pakushtëzuar në shumën 168,659 mijë lekë.
- transferta specifike në shumën 123,126 mijë lekë.

Transferta e kushtëzuar është konfirmuar me shkresë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2960 prot., dt. 19.11.2020 në programin Furnizim e ujë dhe kanalizime.

Qëllimi i PBA- 2022-2024 është prezantimi i strategjive të Bashkisë me terma financiarë dhe tendencat e mundshme të të ardhurave dhe shpenzimeve.
E ardhmja kushtëzohet gjithashtu edhe nga faktorë që nuk varen nga Bashkia, por nga Pushteti Qëndror, siç është rasti i ndryshimeve të politikave fiskale në nivel vendor, implementimi i politikave fiskale nacionale me impakt lokal, transferimi i funksioneve të reja pranë pushtetit lokal etj. Për këtë arsye parashikimet rishikohen çdo vit për të reflektuar ndryshimet në politikat sektoriale të Bashkisë, reflektime që pasqyrohen në **PLANIN E BUXHETIT** vjetor, të cilat analizohen, diskutohen dhe vendimohen në Këshillin Bashkiak.
**Parashikimi i të ardhurave** është bërë duke u bazuar në potencialin e nivelit të gjenerimit të të ardhurave.
Parashikimi Afatmesëm i të ardhurave për vitet 2022-2024 është hartuar mbështetur në realizimin e të ardhurave të vitit 2021, për çdo taksë apo tarifë, si dhe në bazën e të dhënave që ekzistojnë në regjistrat e taksapaguesve të krijuar për çdo njësi administrative në mënyrë të tillë që të kemi një plan të të ardhurave sa më afër realitetit, i cili paraqitet në tabelat në vijim.
Këto parashikime janë të lidhura ngushtë me një sërë faktoresh si :

- Gjendjen në të cilën ndodhet ekonomia e vendit tonë në tërësi si dhe ajo e qytetit tonë në veçanti.
- Trendin rritës në vite të të ardhurave lokale.
- Mos ndryshim të legjislacionit fiskal që është aktualisht në fuqi.
- Masat që do të merren nga administrata tatimore vendore dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë për realizimin e objektivave të Programit.
- Pritshmeria për të ardhmen.

**Çfare parashikojmë në këtë Program Buxhetor Afatmesëm:**

- Ofrim cilësor të shërbimeve publike: pastrim, ndriçim, gjelbërim etj.
- Furnizim normal dhe cilësor me ujë të pijshëm,
- Përmirësim të infrastrukturës në ambjentet mësimore.
- Mbështetje sociale për shtresat në nevojë, gra të dhunuara dhe fëmijët në risk.
- Përmirësim i infrastrukturës rrugore.
- Investime në infrastrukturë.
- Mbështetje për familjet e pastreha.
- Prioritizimin e nevojave për investime dhe sigurimin e burimeve te tjera te financimit, përmes aplikimit me projekte tek donatorë të ndryshëm.

**Planifikimi i shpenzimeve është mbështetur në këto specifika:**
Planifikimi i shpenzimeve është kryer duke u bazuar në ruajtjen e cilësisë së arritur në ofrimin e shërbimeve publike, prioritare për komunitetin si pastrim, ndriçim publik, gjelbërim , mirëmbajtje e varrezave publike, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, mirëmbajtje dhe investime në infrastrukturën rrugore, kulturës e sportit etj, si dhe dhe zgjerimin e shërbimeve sipas mundësive financiare të institucionit.
Në mënyrë të veçantë mbetet prioritet i bashkisë gjetja e mundësive financiare alternative në përmirësimin e infrastrukturës shkollore.

**Njësitë shpenzuese:**

- Bashkia Kuçovë,
- Ndërmarja Komunale,
- Qendra Ekonomike e Arsimit,
- Qendra Kulturore,

## PLANI I TË ARDHURAVE TË VETA:

Plani i te ardhurave per PBA 2022-2024

Në 000/ lekë

| Nr | Emertimi i te Ardhurave Tatimore | Fakti | Fakti | Plani | P/Plani | P/Plani | P/Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Viti: | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
| I. | **Te ardhuranga taksa** | **53,780** | **43,057** | **75,134** | **75,089** | **75,589** | **75,589** |
| 1 | Taksa vendore mbi biznesin e vogël ( TFTH) | 605 | 1,265 | 500 | 500 | - | - |
| 2 | Taksa mbi Ndertesat | 8,477 | 8,895 | 11,448 | 11,448 | 11,448 | 11,448 |
| 3 | Taksa mbi token bujqesore | 6,580 | 5,967 | 13,056 | 13,056 | 13,056 | 13,056 |
| 4 | Taksa e fjetjes në hotel | 131 | 166 | 200 | 200 | 200 | 200 |
| 5 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | 3,914 | 4,971 | 5,000 | 5,000 | 5,000 | 5,000 |
| 6 | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja ( Legalizimet ) | 1,252 | 23 | 2,000 | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| 7 | Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme | 19 | 76 | | | | |
| 8 | Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve | 12,464 | 12,884 | 15,000 | 15,000 | 16,000 | 16,000 |
| 9 | Taksa për zënien e hapësirave publike | 407 | 300 | 1,250 | 1,205 | 1,205 | 1,205 |
| 10 | Taksa e tabelës | 201 | 201 | 600 | 600 | 600 | 600 |
| 11 | Tatimi Ardhurat personale | | 6,997 | 4,700 | 4,700 | 4,700 | 4,700 |
| 12 | Taksa të përkohshme | | | | | | |
| 13 | Taksa e rentes minerare | 495 | 839 | 2,300 | 2,300 | 2,300 | 2,300 |
| 14 | Takse Trualli | 19,041 | 473 | 19,080 | 19,080 | 19,080 | 19,080 |
| II. | **Te ardhura nga tarifat** | **59,177** | **55,106** | **110,078** | **112,205** | **112,269** | **112,369** |
| 1 | Tarifa per pastrim | 30,155 | 28,870 | 35,592 | 37,126 | 37,126 | 37,126 |
| 2 | Tarifa per hapesira publike (Tregu Perq + I Lire +T.L. Mollit) | 7,914 | 6,175 | 8,100 | 8,200 | 8,200 | 8,200 |
| 3 | Tarifa ujit te pijshem | | | | | | |
| 4 | Tarife ndriçimi rrugor | 9,533 | 8,146 | 11,308 | 11,300 | 11,300 | 11,300 |
| 5 | Leje Transporti | 375 | 386 | 400 | 400 | 400 | 400 |
| 6 | Tarife gjelberimi | 8,398 | 6,666 | 8,988 | 10,191 | 10,191 | 10,191 |
| 7 | Tarifa per Reklame | 238 | 193 | | 130 | 130 | 130 |
| 8 | Tarifa parkimi | 307 | 310 | 372 | 350 | 350 | 350 |
| 9 | Tarifa per therjen e bagetive | 3 | | - | | | |
| 10 | Tarife per sherbime te tjera administrative (L.,karb. Vertetime, ) | 250 | 3,119 | 3,030 | 2,020 | 2,020 | 2,020 |
| 11 | Tarife per sherbime kanale kullues e vadites (+vaditje) | 931 | 1,085 | 2,330 | 2,330 | 2,330 | 2,330 |
| 12 | Sporte dhe kultura | | | | | | |
| 13 | Tarifa te tjera(P.Superviz,L.L.drusore,Arkiv,T.Pull etj) | 1,197 | 156 | 500 | 700 | 700 | 700 |
| 14 | Tarifa lokale ( T. Priv. banese ) | 126 | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | Tarifa Mirmbajtje Infr.Arsimore | | | 4,636 | 4,636 | 4,700 | 4,800 |
| 16 | **Tarife e ndotjes mjedisi (Albp)** | | | **34,822** | **34,822** | **34,822** | **34,822** |
| III. | **Te ardhura nga shitja e prones dhe dhenia me qera** | **2,836** | **2,387** | **4,108** | **4,128** | **4,128** | **4,128** |
| 1 | Shitje Ndertese | | | | | | |
| 2 | Shitje Troje | | | | | | |
| 3 | Shitje te pronave te ndryshem | | | | | | |
| 4 | Qera Troje | | | | | | |
| 5 | Qera nga Ndertesat | | 8 | 330 | 350 | 350 | 350 |
| 6 | Interesa nga te ardhurat | | | | | | |
| 7 | Qera toke Bujqesore+Pyjore | 2,836 | 2,379 | 3,778 | 3,778 | 3,778 | 3,778 |
| IV. | Te ardhura nga ndermarrjet Garanci Obj | | | | | | |
| V. | **Te ardhura te tjera** | **19,485** | **15,197** | **19,680** | **17,373** | **17,373** | **17,473** |
| 1 | Tarife per varrezat | | | | 500 | 500 | 500 |
| 2 | Privatizimi I banesave | | | 5,000 | 2,000 | 1,000 | |
| 3 | Debitor | | 8,608 | 9,980 | 10,073 | 11,073 | 12,073 |
| 4 | Transferta e Pakushtezuar | | | | | | |
| 5 | Grant I kushtezuar | | | | | | |
| 6 | Dhurata dhe sponsorizime | 604 | 1,547 | | | | |
| 7 | Te ardhura nga gjobat | 1,752 | 1,305 | | | | |
| 8 | Te ardhura te trasheguara viti I kaluar | | | | | | |
| 9 | Kopshte + Cerdhe | 4,922 | 2,888 | 4,700 | 4,980 | 4,800 | 4,900 |
| 10 | Te ndryshme (,Sekuestrime, Debitore, Te tjera tarifa ) | 12,207 | 849 | | | | |
| VI | **Totali I te ardhurave te veta (I+II+III+IV+V )** | **135,278** | **115,747** | **209,000** | **208,975** | **209,359** | **209,559** |

Te Ardhurat e Programuara per Buxhetin e Bashkise per vitin 2021 mbeshteten ne nivelin e miratuar per taksat dhe tarifat vendore te vitit 2021, data-base per cdo kategori taksapaguesish dhe cdo njesi administrative, si dhe marre ne considerate, realizimin e te ardhurave te vitit 2020, per te gjitha Njesite Administrative; Kucove, Kozare, Perondi dhe Lumas.

Baza ligjore mbi te cilin eshte mbeshtetur hartimi i Programit i te Ardhuarave per vitin 2021 :

- Ligji Nr.9632 date 30.10 2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore " i ndryshuar,
- Ligji Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore" , neni 35 , 36, 37,
- Ligji Nr.68/2017, date 27.04.2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore", kreu III "Të ardhurat e veta te vetë-qeverisjes vendore" , te percaktuara nga neni 10 deri neni 20,
- Vendimi i Keshillit Bashkiak, VKB nr, 79, date 25.11.2020 "Mbi Miratimin e Taksave e Tarifave Vendore per vitin 2021". Ne zbatim te legjislacionit te me sipërmë kemi keto grupe te ardhurash:

I. Te ardhurat tatimore nga taksat dhe tarifat vendore, si:
   - taksa vendore mbi pasurite e luajteshme e te paluajteshme dhe transaksionet mbi to,
   - taksa vendore mbi veprimtarine ekonomike te biznesit te vogel e te madh,
   - taksa vendore mbi veprimtarite e sherbimeve hoteliere,
   - taksa vendore te perkohshme e te tjera te percaktuara me ligj.

II. Te ardhurat jo-tatimore te cilat perbehen nga:
   - te ardhurat nga tarifat per sherbimet e ndryshme
   - te ardhurat nga shitja dhe dhenia me qera
   - te ardhura te tjera.

TE ARDHURAT

Në analizën e treguesve të të ardhurave i referohemi programit te vitit 2021, pasi edhe për tre vitet e ardhshme nuk parashikohet ndonje rritje, për faktin se janë marrë në konsideratë të gjitha burimet e mundshme, ndërkohe qe rritja e tarifave për shërbimet te

kategorite:biznes i madh dhe ndermarje e institucione, kompenson mungesën e të ardhurave te pritshme që vjen si rrjedhoje e migrimit apo emigrimit të popullsisë, pavaresisht programit "modest"te rritjes se tarifave per abonentet familjar. Te ardhurat e Bashkise jane programuar mbi bazen e realizimit te treguesve te te ardhurave ne vite si dhe ne baze regjistrave te krijuar per te gjitha grupet

e tatimpaguesve familjar, te ndermarjeve e institucioneve, biznesit te madh, biznesit te vogel te njesive administrative dhe ato te Bashkise, duke e rritur bazen e takësueshme per çdo vit, per te arketuar sa me shume te ardhura ne menyre te tille qe Bashkia te permbush misionin e saj te percaktuar ne ligjin nr. 139/2015 dt.17/12/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore". Te ardhurat per vitet 2022-2024 jane parashikuar ne vleren 208 975 000 leke per vitin 2022 ,pra ka nje ulje te lehte, krahasuar me vitin 2021,si rezultat i perfundimit te procesit te privatizimit per objektet ne pronesi te bashkise , ne vleren 209 359 000 leke per vitin 2023 dhe per vitin 2024 parashikohen te ardhurat e veta ne vleren 209 559 000 leke.

Programi i te ardhurave per vitin 2021 ne total dhe sipas njesive administrative eshte 209 000 000 leke:

| Njesia Administrative | Vlera/leke ne mije lek | % |
|---|---|---|
| Kuçove | 184 183 | 80.94 % |
| Kozare | 14 926 | 6.56 % |
| Perondi | 20 528 | 9.02 % |
| Lumas | 7 921 | 3.48 % |
| Totali | 227558 | 100 % |

Nga totali prej 227 558 000 leke, vlera prej 18,558 mije eshte detyrim i palikujduar ne 2020 nga AlbPetrol sh.a. Vlerë e cila nuk parashikohet në vitin 2022.
Ndersa realizimi ne vite i te ardhurave paraqitet si me poshte:

Ne mije leke

| Emertimi | Realizimi ne vitin 2018 | Realizimi ne vitin 2019 | Realizimi 2020 | Plani në Vitin 2021 |
|---|---|---|---|---|
| Te ardhura gjith. | 129 231 | 135 514 | 115 747 | 227 558 |

Pra siç e shohim dhe nga tabela e mesiperme se realizimi i te ardhurave per vitin 2020,(duke reflektuar dhe te ardhuren e munguar nga Albpetroli) eshte po ne te njejtin trend, me vitin parardhes, ndersa krahasuar me planin 2020 eshte ne masen 59.5 %, ku peshen e mosrealizimit e ze taksa e truallit nga Baza Ushtarake Ajrore dhe Albpetrol sh.a
Niveli i taksave dhe tarifave është parashikuar sipas VKB nr. 79, date 25.11.2020 "Për Paketen Fiskale Kucova 2021".

## A. TE ARDHURAT TATIMORE

### 1.TAKSA MBI BIZNESIN E VOGEL

Te ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogel ose (tatim fitimi i thjeshtuar) ,ne baze te ligjit te vitit 2020, bizneset nuk paguajne me tatim fitimi. Por duke pasur parasysh detyrimet qe kane nga viti 2020 kemi vendosur nje parashikim 500 000 leke, dhe zero per vitet 2022 deri me 2024.

### 2. TAKSA MBI PASURINE

Te ardhurat e planifikuara nga kjo takse ne zbatim te ligjit nr. 9632, dt..30.10.2006, i ndryshuar , nenet 22 , 23 dhe 23/1 perbehen nga:
a.Taksa mbi ndertesat,
b.Taksa mbi token bujqesore,
c.Taksa mbi truallin,

#### a.Taksa mbi ndertesat,

Planifikimi i te ardhurave nga taksa mbi ndertesen bazohet ne siperfaqen faktike te nderteses ne meter katror me tarifat perkatese te miratuara ne Paketen VKB nr, 79, date 25,11,2020 "Paketa Fiskale 2021":

- per cdo ndertese banimi per familjaret,
- per çdo ndertese ku ne te cilen ushtrohet aktivitet tregtar apo sherbimi nga biznesi i madh dhe biznesi i vogel

Mbeshtetur dhe ne arketimet e viteve si dhe ne baze te regjistrave te krijuar per taksen e nderteses ne bashki dhe njesiteadministrative planifikohen te ardhura si me poshte vijon:

Ne mije leke

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | - |
| Familjaret | 7 130 |
| Biznesi i Madh | 975 |
| Biznesi i Vogel | 3 343 |
| Totali | 11 448 |

Ne zbatim te VKM nr 132 date 07.03.2018, si dhe ne zbatim te Vendimit te keshillit Bashkiak "Per percaktimin e Rregullave Kufizuese ne caktimin e Agjentit Fiskal dhe lidhjen e aktmareveshjes me te", Kryetari i Bashkise Kucove, lidhi mareveshje Me Ujesjellesin sh.a Berat ne rolin e Agjentit i cili me shtrirjen territoriale dhe sistemin kompiuterik te te dhenave, do te beje te mundur qe te kemi maximalizim te arketimit nga kjo takse.

b.Taksa mbi token bujqesore.

Te ardhurat nga kjo takse per vitet 2022-2024 do te arketohet nga tre njesite vendore ne te cilat shtrihet siperfaqja e tokes bujqesore e ndare me ligjin nr. 7501 , dt.19/07/1991 ne baze te regjistrave te krijuar duke u bazuar ne siperfaqen e tokes per çdo tatimpagues si dhe ne vleren per çdo kategori te shprehur ne ligjin nr.9632 , date.30.10.2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", te ndryshuar . Siperfaqja e tokes e ndare me ligjin nr. 7501 date 19/07/1991 ne te tria Njesite a dministrative mbi te cilen llogariten te ardhurat eshte 6122 Ha , e detajuar sipas Njesie eshte si me poshte:

Ne mije leke

| Emertimi i Njesise | Numri i taksapaguesve | Sip.tokes bujqesore | Shuma Ne leke | Ne % Ndaj totalit |
|---|---|---|---|---|
| Njesia Kozare | 2003 | 2230 | 4347 | 33.7 |
| Njesia Perondi | 2162 | 2183 | 5747 | 44.0 |
| Njesia Lumas | 1559 | 1709 | 2962 | 22.7 |
| Totali | 5724 | 6122 | 13056 | 100 % |

Te ardhurat nga tatimi mbi token bujqesore programohen ne vleren 13 056 000 leke, te cilat zene 7 % te totalit te te ardhurave.

c.Taksa mbi truallin.

Ne zbatim te Ligjit nr. 9632, dt 30.10.2006 te ndryshuar , taksa mbi truallin (jo hapesire publike), per vitin 2021, eshte planifikuar rritje ne vleren 19 080 000 leke , e strukturuar sipas kategorive: ndermarrjet , bizneset, dhe familjaret si me poshte vijon:

Tatim mbi truallin ne 000/lekë

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 18588 |
| Familjaret | 405 |
| Biznesi i Madh | 26 |
| Biznesi i Vogel | 61 |
| Totali | 19080 |

3.TAKSA E REGJISTRIMIT TE MJETEVE TE PERDORURA

Kjo takse, ne zbatim te Ligjit nr.9975 dt. 28.07.2008 "Per Taksat Kombetare", vilet nga strukturat e DPSHTRR-Berat dhe te ardhurat nga kjo takse derdhen ne favor te Bashkise ku ne zbatim te ketij ligji Bashkia përfiton 25 % te shumes se arketuar. Te Ardhurat e programuara nga kjo takse per vitin 2021, bazuar ne ecurine e arketimit te kesaj takse ne vitin 2020 do te jene ne masen 15 000 000 leke dhe per vitet 2022-2024, do te jene ne masen 15 000 000 leke per vitin 2022 dhe 16 000 000 leke per vitet 2023 dhe 2024.

4.TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE

Te ardhurat nga taksa e ndikimit ne infrastrukture e cila perbehet nga Lejet per ndertimet e reja dhe legalizimet , do te realizohen ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10 2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore", neni 27, te ndryshuar me ligjin 142/2015 date 17/12/2015 . Mbeshtetur ne realizimin e viteve para ardhese, faktit te vitit 2020, studimit te tregut te Ndertimeve, considerimit ne bashkepunim me ASHK Kucove i kerkesave te mundshme per legalizim, kemi planifikuar rreth 5 000 000 leke per ndertimet e reja. Ndersa nga legalizimi i ndertimeve informale ne baze te zbatimit te procedurave te legalizimit planifikohen rreth 2 000 000 leke.

Si nje aset i vyer per bashkine Kucove, jane dhe te ardhurat qe vijne nga privatizimet e banesave publike, te cilat per vitin 2021,jane programuar 5 000 000 leke, dhe per vitet pasardhese , trendi vijon ne ulje, per shkak te limitit te ketyre aseteve.

5.TAKSE TABELE

Te ardhura nga kjo takse per vitin 2021 dhe per vitet 2022-2024 ne zbatim te ligjit nr. 142/2015, date 17.12.2015, dhe VKB Nr 79 date 25.11.2020, ne te cilin theksohet se per cdo subjekt tregtar apo institucione do te aplikohet taksa 120 leke/vit.

Takse tabele per qellime identifikimi, si dhe duke u bazuar edhe ne verifikimin konkret ne terren planifikojme te arketojme 600 000 leke, nga biznesi i madh e institucionet 400 000 leke dhe biznesi i vogel 200 000 leke.

## B. TE ARDHURAT NGA TARIFAT

### 1. TARIFA PER ZENIEN E HAPESIRES PUBLIKE

Ne zbatim te ligjit nr. 9632 date 30.10.2006, neni 32 te ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015,dt 17.12.2015, kjo tarife, e cila me pare quhej "takse" eshte percaktuar qe niveli i kesaj tarife per njesine administrative Kucove te jete 60 leke/m²/muaj, kurse per njesite e tjera administrative niveli i saj te jete 30 leke/m²/muaj dhe nje kohe perdorimi me 8 muaji ne vit ne baze te VKB nr, 79, date 25.11.2020 "Paketa Fiskale 2021".
Per vitin 2021, nga tarifa e zenies se hapesires publike jane programuar te ardhura me vleren 9 350 000 leke. Duke u bazuar ne kontratat qe planifikojme te lidhim me subjektet e biznesit te madh, te biznesit te vogel per shfrytezimin e hapesires publike, kontratave me ambulantet ne tregun e perqendruar si dhe te ardhurat qe na vijne nga tregu i lire, sipas struktures se subjekteve, jane planifikuar:

Tarifa e zenies se hapsires publike ne 000/lekë

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Biznesi i Madh | 150 |
| Biznesi i Vogel | 1100 |
| Tregu i perqendruar | 6500 |
| Tregu i lire | 1 600 |
| Totali | 9350 |

Per vitet 2022 -2024, programohen nga kjo tarife te ardhura ne masen 9 305 000 leke ne vit.

### 2. TARIFA PER THERJEN E BAGETIVE

Per vitet 2022-2024 mbeshtetur ne legjislacionin ne fuqi , bazuar ne mungesen e arketimeve te deritanishme ( zero leke Arketime nga ky ze per vitin 2020 ), duke mare ne konsiderate qe ne teritorin e bashkise Kucove nuk funksionon asnje thertore, nuk kemi programuar te ardhura nga kjo tarife,
Gjithsesi mbetet te shikohet ne vijim ,qe ne rast te ngritjes dhe funksionimit te thertoreve ne territorin e bashkise,do te Aplikohen tarifa ligjore per kete qellim. dhe do te planifikohen te ardhura.

### 3. TARIFA PER LEJET E TRANSPORTIT DHE PARKIMI

Keto te ardhura sigurohen nga mjetet e Transportit Mall dhe Taksi te cilet pajisen me Leje Transporti dhe Çertifikata vjetore prane Drejtorise se Sherbimeve Publike & Transportit ne Bashki. Per vitet 2022-2024 jane programuar 400 000 leke nga Tarifa per Leje Transporti dhe 350 000 leke nga Tarifa e Parkimit.

### 4.TARIFA E PASTRIMIT

Per vitet 2022-2024 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar 37 126 000 leke, ne baze te strukures te perfituesve te ketij sherbimi sipas grupimit te bere ne bashki dhe ne njesite administrative ku kryhet ky sherbim .
Ne baze te tarifave te miratuara me paketen fiskale per vitin 2021, te dhenave te disponuara nga Drejtoria e te Ardhurave per çdo grup perfituesi dhe sipas njesive administrative jane planifikuar te ardhura si me poshte:

Viti 2021 Ne mije leke

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 11,193 |
| Familjaret | 11,184 |
| Biznesi i Madh | 5285 |
| Biznesi i Vogel | 7930 |
| **Totali** | **35,592** |

Te ardhura do te realizohen nga agjentet fiskal te caktuar per secilen kategori tatim-paguesish:
A) Tarifa e pastrimit per abonentet familjar njesia Kucove do te vazhdojne te arketohen nga Agjenti fiskal Sh.A.U.K Berat -Kucove, nepermjet fatures se ujit te pijshem;
B) Drejtoria e te Ardhurave per subjektet e biznesit dhe ndermarje&institucione; dhe

C) njesite administrative dhe punonjesit e tyre,per abonentet familjar dhe subjektet e biznesit

Ndersa numri i tatimpaguesve perfituesve te ketyre sherbimeve sipas njesive eshte si me poshte vijon:

| Emertimi | Totali | Kuçove | Kozare | Perondi | Lumas |
|---|---|---|---|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 22 | 22 | 0 | 0 | 0 |
| Familjaret | 8 301 | 5 362 | 1009 | 1930 | 0 |
| Biznesi i Madh | 83 | 64 | 5 | 14 | 0 |
| Biznesi i Vogel | 705 | 419 | 95 | 131 | 60 |
| Totali | 9 111 | 5 867 | 1109 | 2 075 | 60 |

1. TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Per vitet 2022-2024 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar qe te jene 11 300 000 leke, ne baze te regjistrave te taksa -paguesve perfitues, dhe sipas njesive administrative jane planifikuar si me poshte:

Ne mije leke

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 386 |
| Familjaret | 7 878 |
| Biznesi i Madh | 773 |
| Biznesi i Vogel | 2 263 |
| Totali | 11 300 |

2. TARIFA PER MJEDISIN DHE GJELBERIMIN

Per vitet 2022-2024 te ardhurat nga kjo tarife jane programuar 10 191 000 leke, sherbim i Gjelberimit dhe Mbrojtjes se Mjedisit ofrohet vetem ne Njesine Administrative Kuçove ne baze te regjistrit te taksapaguesve sipas grupeve parashikohet si me poshte:

Ne mije leke

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 3 500 |
| Familjaret | 3 000 |
| Biznesi i Madh | 2 091 |
| Biznesi i Vogel | 1 500 |
| Totali | 10 191 |

-Ne programimin e te ardhurave per vitet 2022-2024, nje peshe specifike zene te ardhurat nga dhenia me qera te tokes bujqesore e pandare nga ligji 7501, date 19/07/1991, ne 1428 ha, ne vleren vjetore prej 3 778 000 leke, sipas kontratave te perdorimit per 99 vjet, lidhur keto kontrata me ish-Komunat respektive, Perondi dhe Lumas.
Mbetet e rendesishme per te ardhmen ,mundesimi i dhenies me qera te tokes pyjore ne 70 ha qe , si rezultat i punes se Bere nga ana e Drejtorise se Bujqesise per krijimin e regjistrit te pronave, saktesimin e tyre ne terren, hartimit te procedurave ligjore per zhvillimin e ankandit per dhenien me qera, duke kerkuar dhe mirepritur, suportin e strukturave te Ministrise se Bujqesise, per te bere te mundur arketimin e vleres nga ky aset i bashkise.
-Po keshtu dhe nga hapesira ligjore qe jep ligji nr. 68/2017, date 27/04/2017 "Per financat e veteqeverisjes vendore" , neni 14 "Tarifat vendore", germa ç, do te aplikohet nje tarifa e sherbimit per mirembajtje te rrjetit te kullimit e vaditjes, dhe do Te strukturohet mundesimi i arketimit maximal nga keto tarifa, nepermjet nje perpjekje me serioze nga punonjesit e njesive administrative perkatese.
-"Risi" per programin e vitit 2021 e cila do te vijoje dhe ne programin afat-mesem 2022 deri 2024, do te jete Tarifa per mirembajtjen e Sistemit Arsimor, si nje nevoje e kohes, per nje fokusim me te plote ne permiresim te sherbimit qe ofrohet ne sistemin arsimor, qe administrohet nga bashkia, duke pretenduar qe vlera e arketuar e kesaj tarife do te shkoje e gjitha per buxhetin e mirembajtjes se ketij sistemi. E ardhura e programuar nga kjo tarife do te jete 4 636 000 leke ne vit per vitin 2021 dhe po ashtu per vitin 2022, per te vijuar me 4 700 000 leke ne vitin 2023 e me pas ne vitin 2024 ne vleren 4 800 000 leke.
- Ne buxhetin e te ardhurave per vitet 2022-2024, krahas treguesve te analizuar me siper ne perberjen e tij do te jene dhe te ardhurat qe vijne nga sherbimet qe ofron Bashkia Kucove, per frekuentimin e femijeve ne kopshtet e çerdhet e te tjera sherbime.
-Ne buxhetin e te ardhurave per vitet 2022-2024, krahas treguesve te analizuar me siper ne perberjen e tij do te jene dhe te ardhurat qe vijne nga sherbimet qe ka krijuar Bashkia nga kopshtet e çerdhet e te tjera sherbime.

Fondet e parashikuara për funksionet specifike për vitin 2022:

| Programi | Funksioni | Totali/ 000 lekë |
|---|---|---|
| 03280 | Mbrojtja nga zjarri | 15,195 |
| 04240 | Ujitja dhe kullimi | 14,155 |
| 04260 | Administrimi i Pyjeve | 1,535 |
| 09230 | Arsim parauniversitar | 7,243 |
| 09120 | Arsim parashkollor + Qkf | 80,174 |
| 04520 | Rruget rurale | 2,174 |
| 10,430 | Mbrojtja sociale | 2,650 |
| Shuma | | **123,126** |

**PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE:** është bërë në bazë të prioriteteve të Bashkisë për periudhën afatmesme. Në planin e buxhetit 2022-2024 janë parashikuar shpenzimet sipas kontratave shumëvjeçare për shërbime publike, shpenzime operative dhe shpenzimet për investime.

**Nënfunksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit; | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i programit |
| 01110 | Planifikim, menaxhim dhe administrim | • Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;<br>• Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj.<br>• Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë.<br>• Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;<br>• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit; |

Politika e këtij programi konsiston në përmiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë, zhvillimit te kapaciteteve menaxhuese dhe në garantimin e përmirësimit te vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë.

Mbështetur në ligjin 139/2015 "Për Vetë Qeverisjen Vendore", neni 41, neni 34 pika 6, neni 64 pika j, Bashkia paraqet në Këshill, për miratim projekt vendimin "Mbi miratimin e numrit te punonjesve, nivelin e pagave te

administrates, ndermarjeve dhe njesive shpenzuese ne varesi te Bashkise për vitet 2022-2024 dhe numrin e punonjësve për çdo strukturë".

Miratimi i strukturës së punonjësve sjell përcaktimin më të qartë të roleve dhe detyrave të përgjithshme dhe specifike të organizimit të punës, marrëdhënieve ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike dhe paralele, duke përcaktuar dhe qartësuar më mirë kompetencat e çdo njësie të strukturës organizative, duke rritur cilësinë dhe efektivitetin e tyre, me qëllim që të rritet efiçenca e procedurave që realizon institucioni në tërësi. Kjo strukturë i përgjigjet më mirë zhvillimeve të reja dhe kërkesave në rritje, për një shërbim në ndihmë të komunitetit në përputhje me standartet bashkëkohore.

Kjo strukturë e Bashkisë reflekton nevojat aktuale, ajo ndikon drejtpërsëdrejti në zbatimin e politikave përkatëse dhe të shërbimeve që ato realizojnë në praktikën e tyre të përditshme për përmbushjen e nevojave të komunitetit me të cilin ato operojnë.

**Objektivat e politikës së programit:**

a. Fuqizimi i kapaciteteve te burimeve njerezore ne Bashki ne menyre qe ti pergjigjen realizimit te vizionit per te ardhmen e qytetit.
b. Sigurimi i sherbimit cilesor dhe me etikë ndaj qytetareve.
c. Te ofrojë partneritet, koordinim dhe mirekuptim midis paleve duke garantuar mbarevajtje optimale te punes ne sherbim te komunitetit.
d. Krijimi dhe zhvillimi i nje mjedisi ekonomik, ne menyre te tille qe te jete sa me atraktiv dhe konkurues, i cili do te konsolidoje dhe garantoje qendrueshmerine ekonomike gjate periudhës afatmesme.
e. Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
f. Permiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
g. Gjetja e menyrave me efikase per zgjerimin e bazes se taksueshme te bizneseve dhe te familjeve.
h. Vleresim sa me real i detyrimeve te taksapaguesve nga ana e administrates tatimore vendore.
i. Ofrimi i nje sherbimi me cilesor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
j. Asistence dhe keshillim nga administrata tatimore vendore per çdo biznes qe kryen aktivitet tregtar si dhe per çdo individ i cili deshiron te çele aktivitet te ri.
k. Administrim me efiçencë dhe efektitet i sistemit tatimor, përmirësim i infrastrukturës tregtare dhe ulje e informalitetit.
l. Krijimi i marrdhënieve të besimit reciprok midis Bashkisë dhe komunitetit.

**Produktet që synohen të ofrohen:**

- Përmirësimi i vazhdueshëm i kushteve të punës në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit për qytetarët.
- Instalimi i sistemit të rrjeteve kompjuterike për administratën (përmiresim i sistemit të IT).
- Rritja e produktivitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë talentet, potencialin e tyre dhe kohën e punës.
- Sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime.
- Ne bashkëpunim me ASPA , sigurimi i programeve trajnuese që punonjësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë për të qënë më të kualifikuar për të realizuar detyrat që bëjnë aktualisht si dhe për të ecur përpara sipas kërkesave specifike të drejtorive përkatëse duke plotësuar nevojat për trajnime .
- Plotësim i vendeve vakante me nëpunës e punonjës, në bazë të politikave të përcaktuara për rekrutim dhe legjislacionit në fuqi.

**Aktivitetet që synohen të realizohen;**

- Transparencë e plotë e aktivitetit të bashkisë.
- Ofrim i shërbimeve ndaj qytetarëve në një kohë sa më të shpejtë.
- Kthim përgjigje dhe orientim i qytetarëve për zgjidhje, brenda afatit ligjor.
- Informim i publikut në lidhje me procesin e buxhetimit dhe llogaridhënies.
- Krijim dhe përditësim i bazës së të dhënave vendore.

Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë

**PER KESHILLTARET;**

Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore ..." i cili përcakton shpërblimin mujor të këshilltarëve në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë".

Shpërblimi për anëtarët e Këshillit Bashkiak do të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë. Bashkia mbështet 31 këshilltarë dhe 29 kryetarë fshatrash, për realizimin e funksioneve dhe përgjegjësive ligjore.

Shpenzimet për shpërblimin e kryepleqve do të jenë në masën 7 % të pagës së Administratorit të Njësisë Vendore.

**TRANSFERTA;**

- Në zbatim ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore ...", neni 38 planifikojmë që Këshillit të Qarkut t'i transferohen nga të ardhurat e Bashkisë kuote anëtarësie 50, 000 lekë/në vit.
- Transferime agjentit tatimor Drejtorise Rajonale Tatimore për vjeljen e të ardhurave nga biznesi i vogël në masën 1% të shumës së arkëtuar.
- Transferime agjentit tatimor, U.K.B.K për arkëtimin e tarifave nga familjet në masën 2.5% të shumës së arkëtuar nga tarifat.

**FONDI REZERVË:**

Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore.

**Nënfunksioni 011: Organet ekzekutive dhe legjislative, për çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit; | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i programit |
| 01120 | Çështje financiare dhe fiskale | • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.<br>• Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;<br>• Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale. |

**Politika e Programit:**

Politika e këtij programi konsiston në përmiresimin e funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë, në garantimin e përdorimit me efektivitet të burimeve financiare të Bashkisë dhe transparencë të plotë për përdorimin e fondeve publike.

Krijimi dhe zhvillimi i nje mjedisi ekonomik, ne menyre te tille qe te jete sa me atraktiv dhe konkurues, i cili do te konsolidoje dhe garantoje qendrueshmerine ekonomike gjate periudhës afatmesme.

**Objektivat:**

- Promovimi dhe mbështetja e biznesit.
- Përmiresimi dhe zhvillimi i infrastruktures së nevojshme për rritjen e biznesit.
- Gjetja e menyrave me efikase per zgjerimin e bazes se taksueshme te bizneseve dhe te familjeve.
- Vleresim sa me real i detyrimeve te taksapaguesve nga ana e administrates tatimore vendore.

- Ofrimi i nje sherbimi me cilesor dhe brenda nje kohe sa me te shkurter, ne saje edhe te informatizimit teresor te sistemit te taksave dhe tarifave vendore.
- Asistence dhe keshillim nga administrata tatimore vendore per çdo biznes qe kryen aktivitet tregtar si dhe per çdo individ i cili deshiron te çelë aktivitet te ri.
- Administrim me efiçencë dhe efektitet i sistemit tatimor, përmirësim i infrastrukturës tregtare dhe ulje e informalitetit.
- Transparencë të plotë për përdorimin e fondeve publike.

**Produktet që synohen të ofrohen:**

Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.
Informim në kohë reale i taksapaguesve për detyrimet.
Raporte periodike financiare të publikuara.
Familje në nevojë të lehtësuara nga barra fiskale.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 01110:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 21,625,137 | 24,177,442 | 23,216,400 | 23,900,805 | 23,900,805 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 3,501,309 | 3,903,351 | 3,878,000 | 3,878,000 | 3,878,000 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 18,859,810 | 19,215,307 | 19,271,878 | 22,501,203 | 22,501,203 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | 1,416,397 | 7,029,983 | 5,464,730 | 2,321,786 | 2,321,786 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 30,000 | | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | 10,176,624 | 1,500,000 | 1,350,000 | 1,909,000 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *45,432,653* | *64,502,707* | *53,331,008* | *53,951,794* | *54,510,794* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 704,400 | 623,270 | 1,597,410 | 1,000,000 | 800,000 |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | **704,400** | **623,270** | **1,597,410** | **1,000,000** | **800,000** |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | 46,137,053 | 65,125,977 | 54,928,418 | 54,951,794 | 55,310,794 |

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 01120:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 11,135,739 | 12,685,738 | 12,227,000 | 13,118,437 | 13,118,437 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,911,716 | 2,055,000 | 2,038,000 | 2,079,885 | 2,079,885 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 110,000 | 25,000 | | 200,000 | 200,000 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *13,157,455* | *14,765,738* | *14,265,000* | *15,398,322* | *15,398,322* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | 13,157,455 | 14,765,738 | 14,265,000 | 15,398,322 | 15,398,322 |

**Treguesit për funksionin: shërbime të përgjithshme publike.**

| **Të dhënat e programit /vitet** | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. vendimeve të marra nga KB | 102 | 90 | 102 | 102 | 102 | 102 |
| Nr. i dëgjesave publike | 4 | 4 | 6 | 7 | 8 | 10 |
| Nr. i pjesëmarrësve në dëgjesa publike | 60 | 80 | 120 | 150 | 200 | 250 |
| Nr. i vendimeve të publikuara në faqen zyrtare | 102 | 90 | 102 | 102 | 102 | 102 |
| Nr.total i punonjësve | 377 | 376 | 384 | 384 | 384 | 384 |
| Nr. total i pronave | 2837 | 2837 | 2837 | 2837 | 2837 | 2837 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. i pronave të regjistruara | 113 | 97 | 98 | 98 | 100 | 100 |
| Nr. i pronave në proces regjistrimi | 5 | 6 | 4 | 6 | 6 | 6 |
| Nr. i proceseve gjyqësore | 11 | 5 | 5 | 0 | 0 | 0 |
| Nr. i pronave të miratuara me VKM për shpronësim | 0 | 11 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Numri i masave administrative IMT për ndërtime të paligjshme | 20 | 19 | 4 | | | |

**FUNKSIONI 3: RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE**

**Nënfunksioni 031: Shërbimet policore**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore qëjanë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i programit |
| 03140 | Shërbimet e Policisë Vendore | • Sigurimi i mbrojtjes,qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;<br>• Ekzekutimi dhe zbatimii akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe ivendimeve të Këshillit të Njësisë; |

**Objektivat:**

1. Ruajtja e rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike në përputhje me dispozitat ligjore.
2. Të konstatojë, parandalojë dhe ndëshkojë ndotësit e mjedisit.
3. Parandalimi dhe marrja e masave për shmangien dhe prishjen e ndërtimeve të paligjshme dhe zënien e ndërtesave dhe objekteve të Bashkisë.
4. Marrja e masave për ruajtjen e rendit dhe qetësisë ku ka grumbullime njerëzish si në tregje, panaire, ceremoni publike, artistike, kulturore fetare, sportive, në kinema, teatro si dhe mjedise të tjera publike.
5. Të kujdeset për qetësinë publike, duke shmangur zëniet, mënjanuar zhurmat e shkaktuara nga grumbullimet e njerëzve, altoparlantëve që sjellin shqetësim për të tjerët.
6. Kontrolli i respektimit të orarit të shërbimit të njësive tregtare, bufeve e restoranteve lojrave të fatit dhe të objekteve të tjera.
7. Marrja e masave për ruajtjen e pasurisë së Bashkisë.
8. Marrja e masave për shoqërimin në institucionet përkatëse të të sëmurëve me problem mendore, që krijojne shqetësim për rendin publik.
9. Të sigurojë zbatimin e akteve administrative të nxjerra nga kryetari i bashkisë në lidhje me personat fizikë e juridikë që nuk plotësojne konform ligjit detyrimet financiare e fiskale ndaj Bashkisë.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 03140:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 3,474,640 | 3,761,729 | 3,643,000 | 3,879,288 | 3,879,288 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 595,911 | 605,000 | 604,000 | 647,841 | 647,841 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 205,900 | 220,000 | 120,000 | 220,000 | 220,000 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| *Nen-Totali* | ***Shpenzime Korrente*** | *4,276,451* | *4,586,729* | *4,367,000* | *4,747,129* | *4,747,129* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali (korrente + kapitale ) | | 4,276,451 | 4,586,729 | 4,367,000 | 4,747,129 | 4,747,129 |

| **Të dhënat e programit/vitet** | **2019** | **2020** | **2021** |
|---|---|---|---|
| Nr. total i rasteve të trajtuara nga Policia Bashkiake. Nga këto: | 87 | 29 | 10 |
| Nr. i rasteve në mbështetje të prishjes së ndërtimeve pa leje | 4 | 4 | 0 |
| Nr. i rasteve për ruajtjen e qetësisë publike | 16 | 16 | 6 |
| Nr. i rasteve për menaxhimin e konflikteve | 61 | 4 | 1 |
| Nr.total i masave administrative të vendosura | 4 | 4 | 3 |
| Nr. i masave administrative të ekzekutuara | 2 | 1 | 0 |

Nënfunksioni 032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri:

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vinë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor. | | |
| Kodi i programit | Emri i Programit | Përshkrimi i programit |
| 03280 | Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile | • Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;<br>• Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;<br>• Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;<br>• Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj. |

**Objektivat:**

1-Marrja e masave parandaluese për mbrojtjen e jetës së komunitetit dhe të pronës.
2-Forcimi i gatishmërisë së efektivit dhe të mjeteve në dispozicion
3-Rritja e aftësive tekniko fizike e profesionale të efektivit.
4-Përmirësimi i infrastrukturës së Stacionit të M.Z.SH-së.

**Produktet që synohen të ofrohen;**

Ruajtje e jetës dhe e pronës private e publike.
Shërbim i ofruar në kohën më të shpejtë të mundshme.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 03280:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 10,895,621 | 11,105,000 | 11,177,000 | 11,177,000 | 11,177,000 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,810,490 | 1,855,000 | 1,862,000 | 1,862,000 | 1,862,000 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 1,070,700 | 1,874,189 | 1,571,875 | 1,571,875 | 1,571,875 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 346,600 | 3,815,000 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| ***Nen-Totali*** | ***Shpenzime Korrente*** | ***14,123,411*** | ***18,649,189*** | ***14,610,875*** | ***14,610,875*** | ***14,610,875*** |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | 233,000 | 584,125 | 584,125 | 584,125 |
| ***Totali*** | **Shpenzime Kapitale** | **0** | **233,000** | **584,125** | **584,125** | **584,125** |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | 14,123,411 | 18,882,189 | 15,195,000 | 15,195,000 | 15,195,000 |

-Treguesit: Pasqyra përmbledhëse e ndërhyrjeve operacionale të kryera:

| Nr. | Përshkrimi/viti | 2019 | 2020 | 2021 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Objekte civile | 14 | 13 | 6 |
| 2 | Objekte, aktivitet shërbimi, salla, magazina | 1 | 3 | 1 |
| 3 | Objekte turistike | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Shkolla, kopështe e çerdhe | 0 | 0 | 2 |
| 5 | Pika karburanti, gazi, kabina elektrike | 5 | 0 | 6 |
| 6 | Uzina, fabrika, rafineri | 6 | 2 | 1 |
| 7 | Mjete, transporti | 5 | 4 | 2 |
| 8 | Mbetje urbane, pyje, kullota, shkurre | 51 | 75 | 40 |
| 9 | Dyer të blinduara, zhbllokim tubacioni | 19 | 20 | 33 |
| 10 | Alarm fals | 2 | 2 | 2 |
| | **Total** | **103** | **121** | **93** |

## FUNKSIONI 4: ÇËSHTJE EKONOMIKE

### Nënfunksioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 04220 | Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | • Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave;<br>• Informacion i përgjithshëm, dokumentacionteknik dhe statistikapër çështjet dhe shërbimet bujqësore;<br>• Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve;<br>• Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë;<br>• Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë;<br>• Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë e zhvillimin rural. |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit.<br>• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës; |

**Objektivat:**

1.Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave
2.Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore
3.Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinare për blegtorinë

**Produktet që synohen të ofrohen**

Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.
Raporte kontrolli ushqimor dhe kundravajtje administrative.
Fermerë të informuar për grantet për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 04220:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 3,449,170 | 3,403,412 | 3,276,000 | 3,981,103 | 3,981,103 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 594,446 | 550,000 | 542,500 | 684,844 | 684,844 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 20,283 | | | 68,000 | 68,000 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| *Nen-Totali* | ***Shpenzime Korrente*** | *4,063,899* | *3,953,412* | *3,818,500* | *4,733,947* | *4,733,947* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali (korrente + kapitale) | | 4,063,899 | 3,953,412 | 3,818,500 | 4,733,947 | 4,733,947 |

**Nënfunksioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 04240 | Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit | • Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla;<br>• Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore. |

Ky program parashikon mirëmbajtjen e vazhdueshme të kanaleve kryesore, kanaleve te dyta me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin. Sistemet e ujitjes dhe të kullimit funksionojnë për të nxitur dhe mbrojtjur interesat e të gjithë fermerëve. Këto sisteme funksionojnë gjithashtu për të parandaluar erozionin dhe ndotjen, si dhe për mbrojtjen e mjedisit.

**Politika e Programit**

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkise, me qëllim që t'iu mundësojë fermerve ujitjen dhe kullim normal në çdo parcele toke, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje

të vazhduar të sistemit te kanaleve ujitse dhe kulluese.

**Objektivat:**

1. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve ujitëse në tre njësitë administrative.
2. Përmirësimi i kushteve ne sistemin e kanaleve kulluese në tre njësitë administrative.

**Produktet që synohen të ofrohen**

Kanale ujitëse e kulluese të mirëmbajtura.
Kushte të përshtatshme për rritjen e kulturave bujqësore.
Regjistër i bazës së të dhënave i përditësuar.
Punimet e parashikuara për vitin 2022:

| Nr | Emri I kanalit vadites (sipas inventarit, Kollona) | Kanale vadites ne km | Volumi Kanale vadites Ne m3 | Vlera e shpenzimit Ne leke | Sasia e naftes (litra) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vlashuku | - | | | |
| 2 | Havaleas | | | | |
| 3 | Gege | 1 km | 1000 | | 250 |
| 4 | Ferras | - | | | |
| 5 | Frasher | | | | |
| 6 | Salc-Kozare | | | | |
| 7 | **Demollar** | - | | | |
| 8 | Fshati Magjate | 6km- | 2000 | | 450 |
| 9 | Fshati Perondi | 6.5km | 2500 | | 600 |
| 10 | Goraj | 8km | 2000 | | 450 |
| 11 | Rreth Tapi | | | | |
| 12 | **Lumas** | **4km -** | 200 | | 50 |
| 13 | Vodez | **3km-** | 300 | - | 100 |
| 14 | Bardhaj -Sheqez | **4km-** | 500 | | 100 |
| 15 | Pastrim rrugesh | - | - | | |
| 16 | **Total** | **32.5** | **8.500** | | **2.000** |

Të njëjtët nivele punimesh parashikohen dhe në vitet 2023 e 2024.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 04240:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 2,452,440 | 4,447,380 | 3,881,000 | 3,881,000 | 3,881,000 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 389,390 | 742,987 | 644,000 | 644,000 | 644,000 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 2,249,662 | 6,978,345 | 6,300,000 | 6,300,000 | 6,300,000 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| ***Nen-Totali*** | ***Shpenzime Korrente*** | ***5,121,492*** | ***12,168,712*** | ***10,825,000*** | ***10,825,000*** | ***10,825,000*** |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | 24,253,670 | 15,283,717 | 3,330,000 | 3,330,000 |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | **0** | **24,253,670** | **15,283,717** | **3,330,000** | **3,330,000** |
| Totali (korrente + kapitale) | | 5,121,492 | 36,422,382 | 26,108,717 | 14,155,000 | 14,155,000 |

Për vitin 2022 parashikohen 15,283,717 lekë për investime dhe 6,300,000 lekë shërbime operative për mbrojtje nga përmbytjet. Në total për mbrojtje nga përmbytjet parashikohen 21,583,717 lekë.
Treguesit e programit:

| **Të dhënat e programit/vitet** | **2019** | **2020** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr.i familjeve përfituese nga sistemi ujitës e kullues | **3800** | **3900** | **4000** | **4050** | **4100** | **4100** |
| Sistem kullues në km linear | 72 | 72 | 72 | 72 | 72 | 72 |
| Kanal kullues i pastruar në km linear | 15 | 17 | 20 | 25 | 26 | 26 |
| Sipërfaqe e mbuluar me kullim në ha | 1900 | 2500 | 2600 | 2700 | 2750 | 2800 |
| Sistem ujitës në km linear | 84 | 84 | 84 | 84 | 84 | 84 |
| Kanal ujitës i pastruar në km linear | 13 | 25 | 25 | 30 | 30 | 30 |
| Sipërfaqe e mbuluar me ujitje në ha | 260 | 562 | 562 | 630 | 630 | 630 |

**Nënfunksioni 042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 04260 | Administrimi i pyjeve dhe kullotave | • Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore;<br>• Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore;<br>• Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik;<br>• Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh.<br>• Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimii shërbimeve për operatorët pyjorë;<br>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore;<br>• Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore;<br>• Shpërndarja e kullotave, duke përshirë menaxhimin e kullotjes; |

Në zbatim të ligjit nr 48/2018 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" i ndryshuar, të VKM nr. 433 datë 08.06.2016 " Për transferimin në pronësi të bashkive, të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit të ish Komunave /Bashkive", në Bashkinëe Kuçovë janë transferuar 4,707 ha pyje dhe kullota sipas listës së inventarit, e cila është verifikuar dhe janë bërë korrigjimet përkatëse bazuar në

dokumentacionin përkatës. Në bashkëpunim me Shoqatën e Përdoruesve të Pyjeve dhe kullotave "Pylli i Blirit" fshati Frashër, Njësia Administrative Kozare me mbështetjen e Projekteve Mjedisore pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit të financuar nga Banka Botërore, Qeveria Suedeze dhe Organizata Globale e Mjedisit kemi hartuar dokumentacionin për aplikim pranë Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural duke e shoqëruar me projekt propozim për financim të punimeve për përmirësim pyjesh në një sipërfaqe prej 60 ha pyje të llojit lis. Projektet e paraqitura dhe masat e propozuara janë në përputhje me Planin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunale.

**Objektivat e Programit:**

Monitorim periodik i fondit pyjor, për mbrojtjen e pyjeve nga veprimtari të paligjshme si prerje, zaptime, gjueti etj.
Evidentim dhe ndëshkim i rasteve të kundravajtjeve administrative.
Grante, ose financime për të mbështetur rritjn e fondit pyjor.

**Produktet që synohen të ofrohen;**

Komunitet i ndërgjegjësuar për mbrojtjen e fondit pyjor.
Zgjerim i fondit pyjor.
Ndëshkim i rasteve abuzive.
Menaxhim i konfliketeve.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 04260:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 2,978,815 | 4,021,419 | 2,986,000 | 3,303,280 | 3,303,280 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 541,580 | 655,000 | 495,000 | 551,647 | 551,647 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 10,000 | | | 20,277 | 20,277 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *3,530,395* | *4,676,419* | *3,481,000* | *3,875,204* | *3,875,204* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Totali (korrente+ kapitale ) | | 3,530,395 | 4,676,419 | 3,481,000 | 3,875,204 | 3,875,204 |

| Të dhënat e programit/vitet | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Sipërfaqe totale e fondit pyjor dhe kullosor në ha | 4,600 | 4,600 | 4,600 | 4,600 | 4,600 | 4,600 |
| Sipërfaqe e fondit pyjor me plan menaxhimi në ha | 0 | 0 | 0 | 3,000 | 4000 | 4600 |
| Sipërfaqe e fondit pyjor e hipotekuar | 3,668 | 3,668 | 3,668 | 3,800 | 3,900 | 4,100 |

**Nënfunksioni 045: Transporti**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugorbrenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
| 04520 | Rrjeti rrugor | • Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugori trotuareve dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | | sesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjes vendore;<br>• Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimtin e njësisë vendore;<br>• Marrja e masave për lehtësimin e trafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore; |

**Njësi Shpenzuese;**
**Ndërmarrja Komunale**

**Politika e Programit**

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin, me qëllim që t'iu mundësojë banorëve dhe mjeteve qarkullim normal, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar.

**Objektivat e Programit**

Te realizojme mirembajtjen e rrugeve ne masen 70-80% te mirembajtura mire dhe shume mire.
Permiresimin e rrjetit ekzistues te rrugeve te asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal të mjeteve dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve.
Te mirëmbahen trotuaret ekzistuese dhe te shtohen siperfaqet e reja te tyre.

**Produktet që synohen të ofrohen**

Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve.
Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara dhe vendosje pusetash.
Do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojes:
Mirëmbajtje e rrugeve te paasfaltuara prej 204,013 $m^2$.
Mirëmbajtja e rrugeve te asfaltuara prej 501,792 $m^2$.
Mirëmbajtje siperfaqe trotuare prej 39,140 $m^2$.

**BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 04520:**

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 8,320,105 | 10,982,000 | 10,307,000 | 10,620,000 | 10,620,000 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,448,866 | 1,773,540 | 1,722,000 | 1,773,540 | 1,773,540 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 16,417,550 | 18,080,616 | 18,100,000 | 19,311,210 | 19,352,211 |
| 603 | Subvencione | | | | | |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 27,630 | 90,000 | 90,000 | 90,000 | 90,000 |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | | | | | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *26,214,151* | *30,926,156* | *30,219,000* | *31,794,750* | *31,835,751* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | 1,287,600 | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | **0** | **1,287,600** | **0** | **0** | **0** |
| **Totali (korrente + kapitale)** | | **26,214,151** | **32,213,756** | **30,219,000** | **31,794,750** | **31,835,751** |

**FUNKSIONI5: MBROJTJA E MJEDISIT**

**Nënfunksioni 051:** Menaxhimi i mbetjeve

| **Vështrim i përgjithshëm** |
|---|
| Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, sesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. |

| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |
|---|---|---|
| 05100 | Menaxhimi i mbetjeve | • Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;<br>• Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.<br>• Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;<br>• Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. |

Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve;
Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.
Grante, ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve;
Pastrimi i rrugëve, parqeve etj. me qëllim përmirësimin e ambientit dhe uljen e ndotjes.

**Politika e Programit:**

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno - sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti, si dhe në ambientet ku qytetarët te shlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla etj.)

**Njësi Shpenzuese**

Bashkia.

**Objektivat e Programit:**

Pastrimin e rrugëve dhe sheshеve kryesore të qytetit për tu krijuar qytetarëve një ambient të pastër.
Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve urbane në pikat e vend-qëndrimeve të kontejnerëve dhe pikave statike çdo ditë për të krijuar ambiente sa më të pastra dhe uljen e ndotjes në maksimum në blloqet e banimit (lagjesh, pallatesh, e institucione publike).
Grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve inerte në pikat e vendgrumbullimeve dhe pikave statike çdo ditë për të eliminuar ndotjet në blloqet e banimit si dhe në ruajtjen e infrastrukturës mjedisore.
Larja dhe lagia e rrugëve, në rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit për uljen e ndotjes mjedisore nga qarkullimi i makinave dhe punimet ndërtimore.
Përmirësimi i kushteve teknike në vend depozitimin e mbetjeve urbane për uljen e ndotjes së ambientit të qytetit.
Përmirësimi i kushteve teknike në dezinfektimin e pikave nevralgjike në qytet që shkaktojnë ndotje të ambientit dhe në institucionet publike (në vendstrehimet, kopshtet, shkollat, spitalet etj..).

**Produktet që synohen të ofrohen:**

Pastrimi i Rrugëve:

Pastrimi i rrugëve sipas skemës dhe zgjerimi i kësaj skeme në vitet në vazhdim sipas standardeve bashkëkohore duke rritur cilësinë e shërbimit ndaj komunitetit si dhe uljen e ndotjes në mjedisin rrethues.

2. Mirëmbajtja e Ambienteve Publike;
Uljen e ndotjes në mjediset publike ku përfshihen blloqet e pallateve dhe lagjeve të qytetit të cilat nuk janë të planifikuara në skemën e shërbimit ditor.

3. Grumbullim – transportim i mbetjeve urbane;
Largimi çdo ditë sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve urbane nga vendgrumbullimi i kontejnerëve dhe pikave statike.

4. Grumbullim – transportim i mbetjeve inerte (ndërtimore);
Largimi sipas një grafiku të miratuar të mbetjeve inerte nga vendgrumbullimi i mbetjeve urbane dhe ambientet publike.
5. Larje dhe lagie e rrugëve;
Larjen e rrugëve për uljen e ndotjes dhe lagie të rrugëve kryesore gjatë sezonit Prill-Tetor sipas një grafiku të miratuar.

6. Deratizimi dhe Dezinfektimi;
Dezinfektimin, deratizimin, e ambienteve publike për të pasur nja ambient sa më të shëndetshëm për komunitetin.

7. Mirëmbajtja e Vend-Depozitimit të mbetjeve urbane;
Kavaletimi i mbetjeve urbane në vend depozitime për krijimin e kushteve sa më të mira ambientale për mbrojtjen nga

vetëndezja dhe zjarret e mundshme.

8. Mirëmbajtje e mjeteve që kryejnë pastrimin e qytetit;
Për një shërbim çdo ditë të ambienteve ku komuniteti ka në përdorim duhet dhe një gatishmëri sa më efektive e mjeteve që përdoren për largimin e tonelatave mbetje urbane dhe inerteve.

**Treguesit për 2022-2024:**

## I. Sherbimi i pastrimit, grumbullimit e transportimit te mbeturinave urbane. Qyteti Kucove, Njesia Lumas, Kozare dhe Perondi

| Nr | Emërtimi | Njësia | Sasia | Çmimi/ njësi | Ditë pune/vit | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| I. | **NJ.A. Qyteti Kuçovë + Lumas** | | | | | |
| 1. | Fshirja me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve | $m^2$ | 167 000 | 0,098169729 | 312 | 5 115 036 |
| 2. | Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier) | copë | 280 | 85,02849143 | 312 | 7 428 089 |
| 3. | Shërbimi i pastrimit në EC-te publike të qytetit | – | 4 | 907,05054 | 312 | 1 131 999 |
| 4. | Lagie rrugë e sheshe me mjet teknologjik | $m^2$ | 73 000 | 0,154036195 | 220 | 2 473 821 |
| 5. | Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave | ditë | 312 | 5 260,5432 | 312 | 1 641 289 |
| | **Shuma I** | | | | | 17 790 234 |
| II. | **NJ.A. Kozare** | | | | | |
| 1. | Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier) | copë | 95 | 115,2427621 | 156 | 1 707 897 |
| 2. | Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave | ditë | 104 | 7 701,0824 | 104 | 800 912 |
| | **Shuma II** | | | | | 2 508 810 |
| III. | **NJ. A. Perondi** | | | | | |
| 1. | Fshirja me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve | $m^2$ | 29 800 | 0,136835108 | 312 | 1 272 238 |
| 2. | Grumbullim e transportim të mbeturinave urbane në vend depozitim (për kontenier) | copë | 95 | 112,3336674 | 156 | 1 664 784 |
| 3. | Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike e pikat e grumbullimit të mbeturinave | ditë | 104 | 7 555,7944 | 104 | 785 802 |
| 4. | Larja e kontenierëve metalikë | copë | 95 | 77,19406933 | 72 | 528 007 |
| | **Shuma III** | | | | | 4 250 833 |
| | **Shuma Totale (I+II+III)** | | | | | 24 549 877 |
| | **TVSH 20%** | | | | | 4 909 976 |
| | **Shuma Totale** | | | | | 29 459 853 |

## BUXHETI I SHPENZIMEVE PROGRAMI 05100:

| Art | Llogaria ekonomike | Fakt 2020 | Plan 2021 | Plan 2022 | Plan 2023 | Plan 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | | 450,000 | 1,196,000 | 1,198,000 | 1,198,000 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | | 75,150 | 200,000 | 200,100 | 200,100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 32,161,135 | 43,490,415 | 31,460,157 | 35,541,303 | 35,541,303 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | |
| 606 | Trans per Bush. Fam. & Individ | | 0 | | | |
| 609 | Fond rezerve, kontigjence, emergjence | 0 | | | | |
| *Nen-Totali* | ***Shpenzime Korrente*** | *32,161,135* | *44,015,565* | *32,856,157* | *36,939,403* | *36,939,403* |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali (korrente + kapitale)** | | 32,161,135 | 44,015,565 | 32,856,157 | 36,939,403 | 36,939,403 |

*Kontrata me nr. 619 dt. 13.02.2019 për shërbimin e pastrimit është 5- vjeçare. Vlera vjetore e kontratës është 29,459,853 lekë.*
*Ndërsa 3,396,304 lekë parashikohen vetëm për mirëmbajtjen e landfillit dhe nuk janë pjesë përbërëse e kontratës.*

**Nënfunksioni 056: Mbrojtja e mjedisit**

| **Vështrim i përgjithshëm** | | |
|---|---|---|
| Veprimtaritë dhe politikat për mbrojtjen mjedisore. | | |
| Emri i Programit | Përshkrimi i programit | Përshkrimi i programit |

| | | |
|---|---|---|
| 05630 | Ndërgjegjësimi mjedisor | • Administrimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave, planeve, programeve dhe buxheteve përpromovimine mbrojtjes mjedisore;<br>• Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm për mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin mjedisor.<br>• Identifikim, kontroll dhe menaxhim i burimeve ujore brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore |

**Objektivat e Programit;**

- Hartimi i Strategjisë për Kompostim të Mbetjeve Organike.
- Përmirësimi tërësor i sistemit të kanalizimeve, duke ndarë ujërat e bardha nga të zeza në qytet, e duke siguruar mbulim me rrjet për gjithë Bashkinë,
- Rehabilitimi i sistemit të gropave septike në periferi te qytetit por edhe ne fshatrat që nuk kanë akses në rrjetin e kanalizimeve,
- Kryerja e një studimi të integruar për vlerësimin e ndotjes nga nafta në tokë, ajër, ujëra sipërfaqësore dhe Nëntokësore.
- Krijimin e brezit të gjelbërt / fashës së gjelbërt ose zonës ripariane (me 100-200 m gjerësi, sipas rastit të studiuar), përgjatë gjithë gjatësisë së lumit Devoll, Seman dhe Lapardha.
- Ndalimi i shfrytëzimit pa kriter të inerteve lumore në Osum e Devoll: Lumenjtë e Basenit të Semanit janë shfrytëzuar inertet në rrjedhën e mesme dhe të poshtme. Me qëllim mbrojtjen e lumit, ruajtjen e cilësisë së ujërave të tij dhe mbrojtjen e cilësisë së ujërave nëntokësore rekomandohet që Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin e Basenit Ujor të Semanit:
- Të ndalojë urgjentisht shfrytëzimin e inerteve lumore, kryesisht në fillimin e hyrjes së lumenjëve Devoll e Osum në territorin e Bashkisë dhe në lumin e Lapardhasë përgjatë aksit në NJA Lumas, ku është vënë në shfrytëzim intensiv i inerteve lumore.

Arritja e këtyre objektivave do të konsistojë në masat e mëposhtme:

**Masa për mbrojtjen e peizazhit, biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura**

- Përmirësimi i peizazhit në territorin e Bashkisë Kuçovë nëpërmjet shtimit të sipërfaqeve të gjelbra
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara dhe të degraduara nga shkaqe të ndryshme
- Ruajtja e diversitetit të specieve në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë
- Bashkia te lobojë ose të ndërmarrë vetë nismën për inventarizimin e specieve dhe përditësimin e tij për territorin e bashkisë (në bashkëpunim me Ministrine e Mjedisit dhe institucionet të tjera vendore dhe qëndrore, AKM, ARM, AKZM, ARZM).
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Fondit Kullosor,
- Hartimi i Planit të Mbarështimit të Bimeve Medicinale dhe Aromatike,
- Bashkëpunimi me fermerët e zonës për mbarështimin dhe ruajtjen e biodiversitetit e specieve bujqësore dhe blektorale lokale dhe vendase të cilat janë cilësuar si të rrezikuara nga lista e specieve të rrezikuara në shkallë vendi (ne bashkëpunim me ministrine e Bujqësisë dhe Ministrinë e Mjedisit).
- Kontrolli i zbatimit të moratoriumit të ndalimit të gjuetisë dhe prerjeve të pyjeve
- Rehabilitimi mjedisor i fushës së grumbullimit të mbetjeve aktuale, e cila është jashtë standarteve të kërkuara. Venddepozitimi aktual i mbetjeve të ngurta urbane shkakton një sërë problemesh në mjedis, duke ulur cilësinë e elementeve përbërëse të tij, si toka, ajri, uji dhe si pasojë ndikime negative në biodiversitetin e zonës. Ky venddepozitim, duke qënë fare pranë shtratit të lumit vlerësohet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit të tij e, si rrjedhojë, në florën e faunën ujore.
- Te shikohet mundesia e perfshirjes se zones se Sinecit ne zone te mbrojtur.

**Masa për përmirësimin e mbrojtjen e cilësisë së ajrit në Bashkinë Kuçovë.**

Uljen e numrit të makinave në qarkullim nëpërmjet fuqizimit të transportit publik dhe nxitjes së transportit alternativë (siç është transporti me biçikleta), dhe uljen e qarkullimit të numrit të makinave në zonat urbane,

- Shtimin e sipërfaqeve të gjelbra në qytet,
- Hartimin e planeve për uljen e shkarkimeve në ajër nga industria e rëndë.
- Planifikimin efiçent të territorit
- Bashkëpunimin me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM) për monitorimin e përditshëm të treguesve problematikë të ajrit ($P_{M10}$, $NO_2$ dhe Benzenin) deri në përmirësimin e cilësisë së ajrit sipas standarteve ligjore.
- Krijimin e stacioneve të përhershme të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në Qytetin e Kuçovës dhe në zonën naftënxjerrëse në Kozarë ku ka një përqëndrim të lartë pusesh. Për këtë lipset bashkëpunimi me autoritetet përgjegjëse (AKM e ARM, dhe Institutin e Shëndetit Publik). Kostoja e nje monitorimi te vetem 2 javor per parametrat mjedisor te cilesise se ajrit llogaritet dhe parashikohet ne 300.000 leke.
- Krijimi i stacioneve fikse të monitorimit ditor të cilësisë së ajrit në zona me aktivitet të lartë industrial si ajo e naftës.
- Në këtë mënyrë arrihet të kuptohet se cili është ndikimi i industrisë në shëndetin e banorëve të Qytetit të Kuçovës dhe Kozarës. Kjo kerkon investim ne drejtim te blerjes se monitoreve automatik dhe gjysem automatike qe kane nje kosto financiare fillimisht rreth 20 mije euro dhe çdo vit rreth 3 mije euro per mirembajtje te ketyre aparaturave (kryesisht nderrim filtrash).Gjithashtu kjo kerkon dhe kapacitete teknike njerezore (specialist profesionist).

Duke patur parasysh që në territorin e Bashkisë Kuçove veprojnë subjekte të industrisë së rëndë (kryesisht industria e nxjerrjes dhe perpunimit të naftës) të cilët shkarkojnë sasi relativisht të larta në ajër, kërkesë e vazhdueshme e Bashkisë ka qenë që Bashkia:

- të marrë pjesë aktive në dhënien e Lejeve Mjedisore (në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse) të këtyre subjekteve,
- të ndërmarrë nisma të herëpashershme për kontrollin e zbatueshmërisë së kushteve të lejeve mjedisore (të llojit A, B dhe C) dhe të ligjit në tërësi.
- të bashkëpunojë me Inspektoriatin e Mjedisit për zbatimin e normave të shkarkimeve në ajër nga sektori i industrisë.
- Të marrë masa që gjatë ndërtimeve (pallateve në veçanti qe per fat te mire ne Kuçove nuk ka por eshte parashikuar ne planin e masave afategjate) në qytet, të merren masa mbrojtëse për ajrin (të përdoren rrjeta, spërkatje me ujë, etj.)

Të menaxhohen mbetjet sipas parimeve të mbrojtjes së mjedisit (duke shmangur dhe parandaluar djegien e tyre si dhe duke parashikuar kapjen e gazrave që lëshojnë mbetjet gjatë shpërbërjes së tyre në venddepozitimet e mbetjeve. Pra, nevojitet që venddepozitimet e mbetjeve të pajisen me sistemin e kapjes së gazrave që çlirohen nga degradimi i mbetjeve në mënyrë që të mos shkarkohen të pakontrolluara në atmosferë.

**Edukimi mjedisor**

Ne bashkepunim me rrjetet rinore te shkollave, organizatat jofitimprurese mjedisore dhe individ apo biznese te interesuar per mbrojtjen e mjedisit te pergatiten miniprojekte me karakter edukues dhe sensibilizues per mbrojten e mjedisit.

***Shpenzime per studime mjedisore dhe monitorime.***

